

ABEDIN DINO - POET, SHKENCËTAR, ERUDIT

Nga Ahmet Mehmeti
Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Studimeve për Çamërinë

Përveç veprimtarisë atdhetare si burrë shteti, politikan dhe diplomat, rilindasi ynë i madh Abedin Dino (Prevezë, 5 prill 1843 - Stamboll, 9 maj 1906) njihet edhe si poet, kritik letrar, përkthyes, gjuhëtar, ekonomist, filozof, autor tekstesh shkollorë etj. Ai ka dhënë një ndihmesë të shquar në fushën e shkencës së letërsisë, në kritikë letrare dhe përkthim artistik. U dallua veçanërisht për gjykime dhe vlerësime të thella në lëmenj të tillë të shkencave e studimeve të letërsive arabe, persiane, turke etj. Para se të kornte suksese të njëpasnjëshme në përkthimin me nivel të lartë artistik të autorëve më të shquar të letërsive arabo- persiane Abedinit iu desh më parë të jepte prova në poezinë e vet origjinale të shkruar në gjuhën shqipe.

Më 22 dhjetor 1879 Abedini boton pa emër në gazetën “Zëri i Shqipërisë” poemthin me 64 vargje “ **Këngë për Shqipërin’ e shqiptarëvet**” i cili është një sintezë e ideve dhe e ndjenjave atdhetare të Rilindjes. Këtu ai u drejtohet shqiptarëve që të vazhdojnë të ndërtojnë kombin e tyre, të shkruajnë gjuhën e tyre për ta bërë atdheun të lumtur.

Thirrja e tij është:

Bëhuni një e luftoni
Të bëni një Shqipërinë

Në këtë poezi Abedini ngre lartë besën shqiptare si institucion të këtij kombi dhe e shikon të ardhmen e Shqipërisë me optimizëm pasi shqiptarët do t’i bashkojë besa dhe trimëria, karakteristika dalluese të konstruksionit shpirtëror të tyre. Ky poemth është nga të parët dhe më interesantët në letërsinë atdhetare të Rilindjes ku spikat jo vetëm fryma e lartë mobilizuese po edhe figuracioni artistik. Ai ka shkruar edhe poezi të tjera në gjuhën shqipe ndër të cilat përmendim “ **Të nxiturit e Shqipërisë tuke përjeturë**” (Zëri i Shqipërisë, 1 mars 1880), ku u bën jehonë ngjarjeve të luftës për mbrojtjen e Gucisë.

Në mënyrë të veçantë, në fushën e letërsisë, ai u dallua për nivel të lartë artistik sidomos me poezitë origjinale të shkruara në greqisht, që i publikoi në gazetën “ Neologos” e Stambollit dhe “Ermis” e Selanikut etj. Shumë poema epike dhe poezi të tjera u pritën me entuziazëm të madh nga lexuesit e shumtë dhe shtypi grek u bëri jehonë të madhe. Po vepra madhore artistike e Abedin Dinon është përmbledhja poetike në greqisht me titull “**Poezi**” (“**Poimata**”, **Konstandinopol, 1888**), e cila u ribotua në Rodos në vitin 1894, por që fatkeqësisht kësaj radhe nuk pati fatin të qarkullonte. Këto vepra poetike u bënë të njohura deri në Paris, ku shoqëria letrare me emrin “ Silogos” i vlerësoi lartë.

Gazeta “ Shqiptari” e Bukureshtit e majit 1897 e quan Abedin Dinon “ Shkrimtar e poet të shquar, që edhe muzave u ka shërbyer me sukses”.

Në ato vite edhe Naim Frashëri kishte shkruar në greqisht poemthet “Dëshira e vërtetë e shqiptarëve”(Bukuresht, 1886) dhe “Dashuria”(Konstantinopol, 1895) që janë nga më të bukurat e letërsisë shqipe.

Duke qenë turkolog, persolog dhe arabist ai bëri një punë të madhe për t'i lënë brezave një trashëgimi të pasur. Abedini shkroi, përktheu dhe komentoi veprën me fame botërore të klasikut **Xhelaledin Rumi, “Mesnevi”**. Kjo kryevepër e tij u botua në Stamboll në kolanën e Bibliotekës shkencore, në dy vëllime të mëdha me 1668 faqe gjithsej: **“Përkthimi dhe Komenti i Poemës së Shenjtë” (“Terceme ve serh-i Mesnevi-i serif” I-II, Istambul, 1324, Kutuphane-i Irfan)**.

Xhelaledin Rumi, i quajtur shpesh Maulana (rreth 1207-1273), poet i shquar **persian**, në fillim ishte mësimdhënës në Konjë, ka qenë i ndikuar shumë prej mistikut Shemsedin i Tebrizit. Pas vdekjes së Shemsit filloi të shkruante poezi. i ndikuar dukshëm nga muzika, veçanërisht nga ritmet popullore. Shpesh recitimet e vargjeve i shoqëronte me vallzime para nxënësve dhe ndjekësve të tij. I njohur si poeti më i madh sufi, pas vdekjes, dishepujt e tij u organizuan prej sulltan Valadit në vëllazëri të Meulavijëve, të njohur në Europën Perëndimore si “lëvizja e dervishëve”.

Veprat kryesore të tij janë: **“Masnavi-ye- Ma’navi”**, mbi aspekte të sufizmit dhe tjetra **“Divan e Shams”** mbi dashurinë mistike. Përsa i takon sufizmit Gëte e trajtonte atë si praktikë të zigjrit (dhikër).

Në shkrimet rreth Rumiut Gëte pohon lutjen për Allahun dhe bekimin e tij: “Tashmë me të ashtuquajturat ruzare (tespihe) muslimane emri Allah lartësohet me 99 cilësime, rit ky që është si një litani lavdëruese. Pohimi dhe mohimi i cilësive tregon qënien e papërfytyrueshme, adhuruesi i mahnitur përkulet dhe qetësohet”. Ndërsa në pikpamje artistike Gëte kishte të drejtë që magjpejsej pas tipit të metaforës “ fluturoj në dashuri” të Saadiut, fluturim përmes flakës ku vdiset si imazh, për sufiun.. Kjo vërehet veçanërisht në poezinë e “ Divanit të Lindjes dhe Perëndimit” te vërtitja e fluturës përmes flakes te “ Mall i hareshëm”(Selige Sehnsucht), titulli i mëparshëm i së cilës ishte “Vetmohim” (Selbstopfer) dhe “Përsosmëri” (Vollendung).

Ashtu si Gëtja e Federiko Garsia Lorka, që nën ndikimin e letërsive të mëdha arabo- persiane shkruan përkatësisht “ Divani i Lindjes dhe i Perëndimit” dhe “ Divani i Tamaritit”, edhe Abedin Dinoja si një nga njohësit më të mire të këtyre letërsive, tri nga kryeveprat e veta ua kushtoi dy Xhelaledin Rumiut dhe të tretën Al Busirit, i frymëzuar nga këta korifej të letërsisë botërore.

“ Veprën “ Koment i Poemës së Shenjtë “ ai filloi ta shkruante kur ishte vali në Adana më 30 dhjetor të vitit 1884 dhe e përfundoi pas një viti më 19 dhjetor 1885, kur ishte vali në Sivas, pra, e përgatiti dhe e botoi po atë vit.

Kjo vepër është konceptuar dhe krijuar në mënyrë krejt moderne. Pasi jep një dyvargësh në origjinalin persisht, bën përkthimin artistik në gjuhën turke, pastaj vazhdon komentin e dyvargëshit. Komentimi i tij nga kritika letrare dhe teologjike konsiderohet si më i arriri deri më sot, pasi Abedin Dino, duke qenë pjesëtar i sektit halveti, e njihte mirë mistikën islame. Në autobiografinë e vet ai krenohet se ka pasur si udhëheqës shpirtërorë Nuredin Efendiun, kryetar i sektit të nderuar të halvetive me qendër në Stamboll si dhe të atin Ahmet Zenel Abedinin.

Që nga viti 1888, që ishte vali në Ankara, Abedini i qe kushtuar verseteve (ajeteve) të Kuranit. Në librin e vet ai e quan Xhelaledin Rumiun “ mjeshtër të poezisë” dhe sipas mendimit të tij “ nuk mund të gjendet vepër tjetër shpirtërore dhe racionale,

nga ato që kanë dalë nga pena e njerëzimit, e cila të jetë e barabartë me Poemën e Shenjtë”.

“Poema e Shenjtë” për Abedin Dinon është “si një lumë i madh mirësie që gjithë atyre që s’u është prishur mendja e s’janë korrumpuar, u sjell paqe dhe kënaqësi, kurse të pamoralëshmit i çliron nga e keqja”. Ky konceptim i Abedinit është jashtëzakonisht i ngjashëm me atë të Gëtes në poezinë “Muhameti” ku figura simbolike e lumit që rrjedh zotëron pothuajse gjithë krijimin.

I ushqyer me ndjenja të tilla ai shkruan me entuziazëm: “Kënaqësia më e parë shpirtërore e të përlururve të Zotit, pas Kuranit Lavdimadh, është “Poema e Shenjtë”.

Sa ishte gjallë autori, që nga viti 1885 deri më 1905, libri u botua tri herë, botimi i katërt u bë pas vdekjes më 1908. Suksesi i autorit në përkthimin e komentimin e kësaj kryevepre, siç thekson vetë autori, lidhet me faktin se ai nuk përdori fjalë të mëdha e për rrjedhim të pakuptueshme. Në parathënien e librit që u shkrua kur ishte vali në Sivas, ai thekson: “ Kam bërë kujdes që të përdorja shprehje të qarta, të cilat do të mund t’i kuptonte çdo njeri; mendimi im nuk shfaqet me fjali të errëta por me shprehje kuptimplote. Po kështu, idetë që ka arritur të pjellë mendja ime modeste kam synuar t’i formuloj e t’i shkruaj sa kam mundur më shkurt”.

Ishte parim estetik kryesor i tij që të shkruante qartë dhe shkurt. Edhe pse mund të kishte ide dhe mendime sipas Abedinit, por t’i shprehje ato qartë dhe shkurt ishte një punë e vështirë. Pikërisht duke marrë për vete barrën dhe përgjegjësinë e një pune të vështirë, ai është munduar t’u lehtëojë lexuesve kuptimin dhe shijimin e kryeveprave të letërsisë botërore.

Në këtë vepër madhore lexuesi ndjen tolerancën shembullore të qytetërimit islam për të mos paragjykuar idetë me përmbajtje njerëzore universale. Ai pranon gjithë trashëgiminë krijuese letrare filozofike para shfaqjes së Kuranit, mjafton që ajo të përputhet me parimet e tij. Midis përmbajtjes dhe formës, ai i jep përparësi të parës. Ata që duhet të kuptojnë “Poemën e Shenjtë” thekson ai “le të mos e përqëndrojnë vëmendjen te mënyra (forma e naracionit), por te përmbajtja e tij”.

Abedini në veprën e vet madhore nxjerr në pah tiparet dalluese të Xhelaledin Rumiut që e karakterizon përdorimi i simbolit dhe alegorisë. Në të gjitha ngjarjet thekson ai “ kafshët përfaqësojnë gjithnjë njerëz ose qenie me shpirt, me inteligjencë dhe me ide e mendime”.

Një kopje e kësaj kryevepre të Abedin Dinos, në original, ndodhet në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë.

Një tjetër vepër e botuar e Abedin Dinos me temë nga letërsia arabo-persiane, që i kushtohet përsëri Xhelaledin Rumiut, është dhe “ **Komenti i tregimeve arabe në Mesnevinë e Shenjtë**”(“**Mesnevi-i serifteki arabi kisas serhi**”), vepër kjo që përmendet në disa burime dhe që kontribuon në letërsinë krahasimtare. Në këtë degë të shkencës së letërsisë autori ynë i shquar është ndër pionierët e themelimit të saj.

Tjetër vepër me rëndësi të madhe është “**Përkthimi dhe komenti i Kasidatul Burda**” (**Poema e Mantelit**). Kjo poemë është e para që i kushtohet jetës dhe veprës së profetit Muhamet nga poeti i shquar arab **Al-Busiri**,(më i plotë: Sharaf ad – Din Muhamed ibn Said al- Busiri as Sanhaxhi (1212-1295), poet arab me prejardhje berbere. Për jetën e këtij mjeshtri të madh ka të dhëna të pakta. Autori i Al- Burdas hymnizon figurën e Muhamedit; një poemë shumë e përmendur dhe e përdorur si bazë për mevludet pas saj.

Përkthimi mjeshëtor i kësaj kryevepre provon se Abedini ishte njohës sa i arabishtes aq edhe i persishtes. Në fushën e arabistikës Abedin Dino ka dhënë kontributin e tij edhe me librin e botuar në Rodos më 1894/1895 **“Gramatika Arabe sipas metodës së re”** (**“Ber tarz-i nevin nahv-i arabi”**, Rodos,1312). Autorët që e citojnë këtë vepër dëshmojnë se është shkruar në një mënyrë të re dhe se ka përdorur botime të ndryshme evropiane, në dallim nga gramatikat që botoheshin atëherë në turqisht.

Një vepër me rëndësi të veçantë për kohën e vet është edhe libri **”Borxhi Otoman”** që Abedin Dino e shkroi kur ishte Komisar në Bursën e Stambollit. Mbështetur në literaturë të pasur Perëndimore, ai shkruan për veprimet e Bursës, për çështje financiare, probleme të borxheve etj. si dhe përvojën e grumbulluar në Perandorinë Otomane. Si e tillë ajo ka vlera të veçanta si vepër e parë e llojit në kulturën dhe shkencën islame në veçanti dhe në lidhjet e qytetërimit islam me atë Perëndimor në përgjithësi.

Një tjetër vepër interesante që pa së pari dritën e botimit në Rodos e pastaj në Stamboll është libri kushtuar çështjeve etike **“Lumturia në këtë botë”** (**“Dunya-yi se’adet”**, **Matbaas-i Vilayet, Rodos,1312**), e cila më vonë u botua në Stamboll. Vepra ka karakter polemizues me ateistët dhe darvinistët. Qetësinë shpirtërore dhe fatin e njeriut ai i gjen në besim. Pikpamjet e veta autori i mbron duke u mbështetur në autorët e njohur perëndimorë (Paskal, Flamarion, Montegace etj).

Në veprën **“Lumturia në këtë botë”**, Abedin Dino shpreh rëndësinë e jashtëzakonshme të librave dhe të letërsisë: **“Të lexosh, gjithmonë të lexosh, pa u shkëputur, të jesh njeri i apasionuar pas leximit është në një kahe të qartë lumturia më e çmuar e gjithë lumturive tokësore”** dhe vazhdon: **“Njerëzit mund të braktisen nga të dashurit dhe miqtë, por librat mbeten miqtë më besnikë”**.

Në këtë periudhë të veprimtarisë së tij krijuese ju dorëzua dekorata më e lartë e Akademisë Franceze, **“Palme”** (1895), për merita të shquara në fushën e kulturës e të letrave.

Abedini u dallua edhe si hartues veprash të mirëfillta filozofike-teologjike si: **“Mbrojtja e botës islame”** (**“Alemi-i islamiyeti mudafata”**, **Stamboll,1313**), ku polemizon me një misionar të krishterë, i cili kishte botuar në Kajro një liber në arabisht kundër fesë islame. I kësaj natyre është edhe libri tjetër i tij **“Mendimi Islam”**. Ai u shqua gjithashtu edhe në haritmin e mjaft teksteve në fushën e arsimit etj.

Shumë e veçantë në krahasim me botimet e përmendura më parë na vjen broshura **“Trajtesë e dobishme mbi kolerën”** (**“Kolera hakkinda mekal-i nafis”**, **Matbaa-i Vilayet, s.a**), botuar në Ankara pa vit botimi. E shkroi në kohën kur u hap kolera në vilajetin e Ankarasë. Në të jep udhëzime për masat preventive dhe si duhet izoluar i sëmurit. Siç vë në dukje Hasan Kaleshi vepra është kompiluar sipas librave mjekësore franceze. Tërheq vëmendjen përgjegjësia dhe akti i qytetarisë që shtyn autorin t’i futet një punë të tillë pa qenë specialist në këtë fushë. Por aftësitë e jashtëzakonshme dhe shpirtmadhësia e Abedinit për t’iu gjendur njerëzve nevojtarë, justifikon përpjekjet e tij altruiste. Duke qenë njeri publik, shume herë vali, nuk mund të rrinte indiferent para fatkeqësive të tilla. Ndihmesa e tij për t’ju gjendur pranë njerëzve në vuajtje ishte kënaqësia e tij më e madhe. Gjithë veprimtaria e tij është mishërim i kulturës së gjithanshme dhe humanizmit pa kufij.

Me vlerë të veçantë për historiografinë shqiptare është edhe “**Autobiografia**” e Abedin Dinos, e cila për fatin tonë të mirë është botuar katër herë, në fillim të veprës së tij “ Komente dhe përkthime të Poemës së Shenjtë”.Ajo u shkrua më 25.6.1888. Siç vërehet nga leximi i saj, autobiografia është çensuruar, por edhe ashtu siç na jepet, ajo ka vlera të jashtëzakonshme për studimin e historisë së kombit shqiptar dhe kulturës së tij.

Ahmet Mehmeti

Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Studimeve për Çamërinë

www.cameriainstitute.org